



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 520/1 Prot.

Vlorë më, 29.4. 2022

VENDIM
Nr. 21, datë 29.04.2022

PËR
MIRATIM E HAPJES SË PROGRAMIT TË DYFISHTË TË STUDIMIT MASTER
SHKENCOR NË "PROJEKTIM DHE MENAXHIM I SISTEMEVE TURISTIKE
DHE KULTURORE".

Në mbështetje të nenit 38, nenit 71 "Programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë", nenit 75 "Programet e ciklit të dytë të studimeve", të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr.1, datë 14.04.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Universitetit të Vlorës dhe Universitetit të Barit "Aldo Moro", miratuar në Mbledhjen e Departamentit të Ekonomisë, Menaxhimit dhe të Drejtës së Ndërmarrjes, me Nr. 0000687, datë 28.04.2022, Senati Akademik në mbledhjen e datës 29.04.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Biznesit, Fakulteti i Ekonomisë për hapjen e programit, të dyfishtë (Double Degree), në ciklin e dytë të studimit Master Shkencor në "Projektim dhe Menaxhim i Sistemeve Turistike dhe Kulturore".
2. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. **ROLAND ZISI**

